
PROCESI I INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN DHE PENGESAT NË KËTË PROCES

THE INTEGRATION PROCESS OF ALBANIA INTO EUROPEAN UNION AND THE OBSTACLES IN THIS PROCESS

ADELINA NEXHIPI

Adresa: Bul. "Kiço Greço", Kom. City Center, Lagj. 9, Korçë
email: adelinanexhipi@yahoo.com

AKTET VI, 3: 270-275, 2013

PËRMBLEDHJE

Të gjitha qeveritë shqiptare, të pas vitit 1990, të spektrit të djathtë apo të majtë, në qendër të politikës së tyre vunë integrimin e Shqipërisë në organizmat euro-atlantik. Marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-në u vendosën në vitin 1991. Në 12 Qershor 2003 u nënshkrua në Bruksel MSA-ja dhe hyri në fuqi në janar 2009. Sot Shqipëria ende nuk ka marrë statusin e shtetit kandidat për në BE. Ky punim modest ka për qëllim të ndërgjegjësojë njerëzit për hapat që kemi bërë, përgjegjësitë që kemi të gjithë ne dhe detyrat që na dalin përpara. Pse kaq e gjatë rruga e antarësimit të Shqipërisë në BE? Cilët janë faktorët që vonojnë anëtarësimin e Shqipërisë në BE? Pikërisht këtyre pyetjeve do të përpiqem t'u përgjigjem në punimin tim. Nëpërmjet këtij punimi do të sjellë një panoramë analitike të rrugës së Shqipërisë për anëtarësimin në BE, arritjet, pengesat në këtë proces.

Fjalët çelës: Shqipëri, Bashkim Evropian, integrimi, pengesa.

SUMMARY

All Albanian governments after the nineties, in the center of their policies established Albania's integration in Euro-Atlantic Organizations. Albania's relations with the European Union was established in 1991. On June 12, 2003 was signed in Brussels the Stabilization and Association Agreement entered into force in January 2009. Today Albania has not yet received the status of candidate country for the European Union. This modest paper aims to raise awareness of people for the steps we have done, for all the responsibilities we have and duties that come in front of us. Why such a long path of European Union membership? What are the factors that delay Albania's membership in the European Union? It is precisely these questions that I will try to answer in my thesis. Through this paper I will try to bring an analytical overview of Albania's road to European Union membership, the obstacles in this process.

Key words: Albania, European Union, integration, obstacles.

HYRJE

Marrëdhëniet diplomatike të Shqipërisë me Bashkimin Evropian (BE) u vendosën në vitin 1991. Në 11 maj 1992 u nënshkrua Marrëveshja e Tregtisë dhe Bashkëpunimit përfshirë dhe deklaratën e përbashkët mbi dialogun politik, e cila hyri në fuqi më 1 dhjetor 1992. Shqipëria u përfshi në Sistemin e Përgjithshëm të Preferencave. BE u bë donatori kryesor për Shqipërinë. Në maj të vitit 1999, BE miratoi një

iniciativë të re për vendet e Ballkanit, të quajtur Procesi i Stabilizim-Asociimit (PSA). Ky proces ka për qëllim vendosjen e marrëdhënieve më të ngushta ndërmjet BE-së dhe vendeve nënshkruese, nëpërmjet Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit (MSA).

Prespektiva e vendeve të rajonit perëndimor për integrim në BE, përforcohet pas Këshillit Evropian të Feiras (qershor 2000), i cili vendosi se të gjitha vendet e përfshira në PSA janë candidate

potenciale për anëtarësim në BE. (http://www.evroparl.evropa.eu/summits/fei1_en.htm)

Kjo u ndoq nga takimi i nëntorit të vitit 2000 në Zagreb, ku morën pjesë vendet e përfshira në PSA. Në këtë takim BE-ja vendosi të intensifikojë bashkëpunimin me Shqipërinë nëpërmjet krijimit të Grupit të Nivelit të Lartë Drejtues: Shqipëri-BE. Qëllimi i këtij grupi ishte të vlerësonte kapacitetin e Shqipërisë për të marrë përsipër detyrimet për një MSA me BE-në.

Komisioni vlerësoi se, ndonëse mbetej ende për të bërë në drejtim të plotësimit të detyrimeve që rridhnin nga MSA-ja, *perspektiva e hapjes së negociatave ishte rruga më e mirë për të ruajtur tempin e ndryshimeve politike dhe reformave ekonomike në vend*. Për këtë qëllim, Komisioni arriti në përfundimin se ishte çasti për të proceduar me një MSA me Shqipërinë. (<http://www.mfa.gov.al/>)

Negociatat me Shqipërinë, u hapën zyrtarisht nga Presidenti i Komisionit Evropian, zoti Romano Prodi, më 31 janar 2003.

Qëllimi i MSA-së është vendosja e stabilitetit politik dhe ekonomik të shtetit kandidat. Pikërisht për këtë arsye kjo marrëveshje përmban detyrime asimetrike në favor të tij. Për t'u bërë palë e marrëveshjes, Shqipëria duhet të plotësojë kriteret e Kopenhagenit. Shqipërisë do t'i duheshin tre vjet derisa, në shkurt të vitit 2006, në Tiranë të siglohej MSA-ja dhe më 16 qershor 2006, në Luksemburg, në Këshillin e Çështjeve të Përgjithshme dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të nënshkruhej MSA-ja dhe Marrëveshja e Përkohshme për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar.

Një moment shumë i rëndësishëm për afrimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor me BE-në ka qenë Samiti i Selanikut (viti 2003), ku u theksua në mënyrë të veçantë perspektiva e anëtarësimit të këtyre vendeve në BE.

Gjatë këtij samiti nuk u la asnjë dyshim se ecuria e procesit të integritetit evropian varet nga performanca individuale e secilit vend në drejtim të reformave ekonomike, standardeve demokratike, respektimin e të drejtave të njeriut, qeverisjen e mirë dhe respektimin e shtetit ligjor.

“BE-ja do të bëjë gjithçka për ta ndihmuar këtë rajon që të ketë sukses, por anëtarësimi duhet merituar”, ishte një nga mesazhet kryesore të Samitit të Selanikut.

(http://ec.evropa.eu/enlargement/press_corner/key-documents/sap_en.htm)

Në pjesën ku përshkruhen vlerësimet e BE-së për secilin vend të Ballkanit Perëndimor, për Shqipërinë, ndër të tjera, thuhej se *stabiliteti politik dhe progresi në reforma lejoi hapjen e negociatave me Shqipërinë për MSA-në. Vazhdimi dhe konsolidimi i klimës së mirë politike dhe të një politike të qëndrueshme për reformat mbetet parakusht për progres të mëtejshëm drejt BE-së. Fokusi duhet të jetë mbi përmbushjen efektive të reformave*. (po aty)

Në zbatim të angazhimeve të Axhendës së Selanikut, më 30 mars 2004, Komisioni Evropian paraqiti Partneritetin Evropian për Shqipërinë që u miratua nga Këshilli i Ministrave të BE-së në qershor të vitit 2004. Në përgjigje të këtij dokumenti të BE-së, në shtator të vitit 2004 Qeveria shqiptare miratoi Planin Kombëtar të Veprimit.

Gjithashtu, në zbatim të angazhimeve të Axhendës së Selanikut, institucionet e BE-së kanë bërë hapjen e programeve komunitare për vendet e PSA-së, në shkëmbimin e eksperiencës me vendet candidate në fushën e ndërtimit institucional si dhe në rritjen e asistencës financiare për rajonin, të cilat do të ndikojnë për ecurinë e përmbushjes së reformave dhe afrimin e standardeve me ato komunitare.

BE ka pasur një angazhim konkret në Ballkanin Perëndimor që prej vitit 1991. Programet e ndihmës në këtë drejtim kanë qenë “PHARE”, fillimisht, dhe “CARDS” më pas. Këto programe kanë synuar të ndihmojnë vendet e Ballkanit Perëndimor përfshi edhe Shqipërinë, për të përparuar në procesin e Integritetit Evropian, duke u përqendruar tek rindërtimi i vendit, zhvillimi dhe stabilizimi i arritjeve në planin politik, ligjor dhe ekonomik.

Për periudhën 2001-2006, asistenca e përgjithshme “CARDS”, akorduar Shqipërisë, ishte 282.1 milionë euro.

Programi i ri i asistencës së Bashkimit Evropian për Shqipërinë u quajt IPA (Instrumenti i para anëtarësimit).

Ndihma e para pranimit për Shqipërinë është vendosur në 245 milionë euro, nga të cilat 215 milionë euro janë caktuar për ndërtimin e institucioneve, veçanërisht reformën gjyqësore e administrative dhe për luftën kundër krimit të organizuar e korrupsionit. 30 milionë euro do të mbështesin nismat e bashkëpunimit ndërkufitar. (<http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/articles/2008/10/20/reportage-01>).

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit u ratifikua nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe më 1 prill 2009 ajo hyri në fuqi. Pas kësaj,

- më 28 prill 2009, Shqipëria paraqet apikimin e saj për anëtarësimin në BE
- më 16 dhjetor 2009 mbërrin në Tiranë pyetësi i Komisionit Evropian, ndërsa qeveria shqiptare dorëzon përgjigjet në Bruksel më 14 prill 2010
- më 15 dhjetor 2010 hyn në fuqi liberalizimi i vizave për shtetasit shqiptar që udhëtojnë në vendet e zonës Shengen.

Procesi i anëtarësimit në BE kalon nëpër disa faza. Shqipëria ka kaluar 3 fazat e para (nënshkrimin e MSA-së, hyrja e saj në fuqi dhe aplikimin për anëtarësim), pas kësaj ajo duhet të marrë statusin e shtetit kandidat e më pas të hapen negociatat për anëtarësim, e vetëm pas përfundimit të negociatave mund të arrihet anëtarësimi i plotë në BE. Por mesa tregojnë faktet rruga e Shqipërisë për anëtarësim në BE është ende e gjatë. Asaj i është refuzuar 2 herë marrja e statusit të shtetit kandidat, në vitin 2010 dhe 2011-n. Për të analizuar pengesat në këtë proces jam mbështetur në dokumentat zyrtare të BE-së, kryesisht progres-raportet e përvitshme për Shqipërinë.

Pengesat në procesin e integritimit

Zhvillimet politike në vend: paqëndrueshmëria politike, demokracia e brishtë dhe mugesat e kulturës demokratike; korrupsioni; krimi organizuar kanë qënë pengesë në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE. Këto janë vënë në

dukje në mënyrë të përsëritur në progres-raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë.

Shqipëria mbetet një demokraci e re dhe relativisht e paqëndrueshme. Interesat afatmesme të vendit shpesh sakrifikohen përballë interesave afatshkurtra dhe të ngushta politike. Konsolidimi i kulturës demokratike është thelbësor për kryerjen e reformave të domosdoshme. (Raporti i Stabilizim Asociimit 2004)

3.a. Mbajtja e zgjedhjeve të lira e demokratike dhe bashkëpunimi politik

"Zgjedhjet; një shans i humbur për Shqipërinë", do të shprehej kreu i Misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR-it në Tiranë, menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve lokale të vitit 2007 në Shqipëri. Duke cituar pikërisht këtë frazë, mendja të shkon tek të gjitha raportet e mëparshme, të cilat gjithmonë do të cilësonin "progres" të bërë pas çdo procesi zgjedhor, por që asnjëherë ky "progres" nuk ishte i mjaftueshëm për t'u cilësuar "i suksesshëm". Pra, e thënë me fjalë të tjera, zgjedhjet mund të konsiderohen si "thembra e Akilit" për demokracinë shqiptare.

Nëse do t'i referoheshim raporteve të progresit të lëshuara nga BE-ja për Shqipërinë, do të kishim diku më shumë e diku më pak fraza të tilla:

"Shqipëria ka bërë progres të kufizuar në trajtimin e shumë sfidave që ajo duhet të përballojë... stabiliteti politik relativ, por akoma i brishtë,... disa progrese lidhur me zbatimin e rekomandimeve të komunitetit ndërkombëtar për përmirësimin e procedurave zgjedhore..." (Raporti i Stabilizim-Asociimit 2003)

"Zgjedhjet vendore të 12 tetorit u zhvilluan në bazë të një kodi të ri zgjedhor. Megjithatë, mangësi serioze u vunë re gjatë këtyre zgjedhjeve dhe nuk u arritën standardet e kërkuara ndërkombëtare..." (Raporti i Stabilizim-Asociimit 2004) ose

"Pavarësisht nga përmirësimi i kodit zgjedhor, në zgjedhjet lokale të tetorit 2003 u shfaqën të meta serioze." (Progres-Raporti 2005)

"OSBE/ODHIR konstatuan nevojën e adresimit të disa çështjeve, përfshi këtu problemet teknike dhe administrative, shqetësimet në lidhje me "votimin

strategjik”, heqjen e së drejtës së votës një numri studentësh, mungesa e përmirësimit të pjesëmarrjes së femrave në çështjet publike dhe, mbi të gjitha, nevojën për të përmirësuar më tej listat e votuesve. Mangësitë e zgjedhjeve treguan nevojën për përmirësimin e mëtejshëm të ligjeve dhe praktikave zgjedhore, si dhe nevojën urgjente për punë të mëtejshme në përmirësimin e regjistrimit civil.” (Progres-Raporti 2006)

Edhe kur nuk ka pasur periudha zgjedhesh, përsëri politika shqiptare nuk i ka shpëtuar ngërçit në të cilin futet herë pas here, për hir të mosmarrëveshjeve dhe debateve që përfshijnë forcat kryesore politike në vend. Kështu, periudhat e ngërceve politike në pranverën dhe verën e vitit 2006, penguan përpjekjet e Parlamentit të merrej siç duhej me çështjet e reformave të rëndësishme, veçanërisht ato që kërkojnë konsensus të gjerë politik. Klima e dobët politike pengoi punën e grupeve parlamentare për reformën zgjedhore dhe marrëveshjet e ngadalta politike vonuan emërimin e anëtarëve në Komisionin Qendror Zgjedhor.

Për arsye të mos gjetjes së një gjuhe të përbashkët në drejtim të reformës zgjedhore, raporti i fundit i vitit 2007 i KE-së do të vinte në dukje: “Mosmarrëveshjet politike vonuan zgjedhjet vendore të 2007-s dhe çuan në mjaft mangësi teknike. ODIHR dhe misioni vëzhgues i Këshillit të Evropës, raportuan se zgjedhjet ishin konkurruese, por ishin një mundësi e humbur për mbajtjen e zgjedhjeve në përputhje të plotë me angazhimet dhe standardet ndërkombëtare.” (Shih Progres-Raporti 2007) Kështu vazhdoi të thellohej edhe më hendeuku midis forcave politike në Shqipëri dhe kjo u duk edhe në zgjedhjet e pjesshme parlamentare. Debatet e vazhdueshme partiake çuan në bojkotimin nga opozita të zgjedhjeve të pjesshme parlamentare në pranverë të vitit 2007.

Shqipëria vazhdon të mos e ketë gjetur ende rrugën e saj, për sa i përket një bashkëpunimi të frytshëm midis forcave politike, për të ndërmarrë vendime dhe për të pasur një axhendë të përbashkët në të mirë të vendit dhe në drejtim të integritetit Euro-Atlantik. Pra, klasa politike ende nuk e ka demonstruar se ka kapacitetet për të

arritur një bashkëpunim politik, pa ndërhyrjen e faktorëve nga jashtë, duke vënë mbi interesat partiake apo ato individuale, interesat e kombit shqiptar

3.b Reforma në administratën publike

Aftësia e administratës publike për të vënë në zbatim MSA-në, në rastin e Shqipërisë ka qenë një ndër pikat e dobëta në procesin e integritetit. Është administrata publike që ka për detyrë të vërë në zbatim angazhimet që ndërmarrin qeveritë në kuadër të këtij procesi.

Problemet me të cilat është ndeshur administrata publike gjatë viteve të tranzicionit kanë qenë të shumta: rekrutimi i nëpunësve të administratës mbi baza lidhjesh nepotike e politike, arbitrariteti i lëvizjeve dhe pushimeve nga vendi i punës, mungesa e praktikave të punës dhe logjistikës së nevojshme, trajnimet e pamjaftueshme, puna e dobët që kryhet nga strukturat monitoruese të punonjësve të administratës, pagat e ulëta dhe mungesa në përgjithësi e motivimit të nëpunësve civilë.

Kjo gjendje e administratës publike është vënë re dhe është përmendur nga KE në raportet monitoruese për Shqipërinë. Në veçanti KE është treguar mjaft skeptik në lidhje me aftësitë e administratës publike të Shqipërisë për të zbatuar MSA-në. Kjo ka qenë njëra prej arsyeve kryesore për shtyrjen kaq të gjatë të nënshkrimit të MSA-së. Kështu, raporti i KE-së për Shqipërinë, i vitit 2003, do të theksonte se edhe pse ishin bërë përpjekje nga Shqipëria për të forcuar administratën publike, ajo mbetej e dobët, pjesërisht nga zbatimi i pamjaftueshëm i kuadrit ligjor, rasteve të korrupsionit, ndërhyrjeve politike dhe vështirësive nga institucionet e administratës publike qendrore për të mbrojtur pozicionin e tyre ndaj Qeverisë. (Raporti i Stabilizim-Asociimit 2003)

Detyrimet e Shqipërisë të parashikuara në MSA do të shoqërohen me fonde të mëdha në kuadër të programeve të asistencës komunitare.

Nga ana tjetër, duke qenë se fenomeni i korrupsionit nuk është një rast i veçantë në administratën publike shqiptare, por, përkundrazi, ndeshet shpesh dhe në përmasa të

gjera, është e natyrshme që Brukseli nuk dëshiron që paratë e ardhura prej taksave të qytetarëve evropianë të pasurojnë në mënyrë të paligjshme disa njerëz në Shqipëri. Pa një administratë publike të aftë për të kuptuar proceset integruese dhe me vullnetin e ndërgjegjen e duhur profesionale, Procesi i Integritetit të Shqipërisë në BE nuk mund të përparojë.

3.c Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit

Çështjet e brendshme dhe drejtësia kanë qenë kryefjala e pothuajse të gjitha raporteve që Komisioni Evropian ka nxjerrë, për sa i përket ecures së reformave integruese në Shqipëri.

Për Shqipërinë, gjithnjë e më shumë, në raportet e viteve të fundit të KE-së është vënë theksi mbi përpjekjet që duhet të bëjë dhe sfidat që duhet të përballohen në drejtim të forcimit të drejtësisë, përmirësimit të sistemit gjyqësor dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kështu, Barroso do të shprehej:

“Shqipëria duhet të bëjë përpjekje serioze për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Për ta bërë një gjë të tillë, Shqipëria duhet të ndërthurë masat e ashpra për ata që e shkelin ligjin, me ngritjen e një gjyqësori të fuqishëm e të pavarur, gjë që kërkon integritetin e gjykatësve, për të siguruar që të ketë një ligj për të gjithë.” (Fjala e Barrosos në Kuvendin e Shqipërisë, shkurt 2006. Shih www.parlament.al)

Shqipëria vazhdon të cilësohet nga raportet ndërkombëtare si një vend me rrezik të lartë korrupsioni. Qeveria, politika dhe administrata shqiptare nuk kanë bërë mjaftueshëm në lidhje me luftën anti korrupsion. Në vitin 2006, Shqipëria renditej në vendin e 111-të dhe është vlerësuar me notën 2.6 për nivelin e korrupsionit; në 2005 Shqipëria është vlerësuar me notën 2.4, e 126-ta në klasifikimin botëror; në 2004 e 108-ta; në 2003 e 92-ta në klasifikim.

(<http://www.cpi.transparency.org/>)

Kurse për sa i përket luftës kundër krimit të organizuar theksi vihet te reformat në fushën e drejtësisë, pastrimin e parave si dhe luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore e drogave.

Nëse do t'i referohemi raportit të vitit 2007, theksohet se procedurat gjyqësore përgjithësisht vazhdojnë të jenë të ngadalta dhe u mungon transparenca. Po kështu, masat e qeverisë për të luftuar korrupsionin në gjyqësor çuan në konflikt të vazhdueshëm ndërmjet ekzekutivit dhe gjyqësorit, veçanërisht me Prokurorin e Përgjithshëm. (Progres-Raporti 2007)

Është pikërisht kjo çështje që vazhdon të zvarritet nëpër dyert e politikës ende në ditët e sotme dhe që akoma nuk po e gjen rrugëzgjdhjen. Ende nuk është arritur vendosja e ekuilibrave në raportet midis niveleve të pushteteve në vend.

Konkluzione dhe rekomandime

Politikanët shqiptare duhet të:

- Gjejnë një qasje pragmatiste, ku mundësitë dhe sfidat e procesit të diskutohen në mënyrë të balancuar dhe neutrale. Kjo kërkon një përgjegjësi dhe përgjegjshmëri të plotë nga ana e të gjitha forcave politike në vend.
- Arrijnë një konsensus të gjerë politik dhe të vënë interesat kombëtare përmbi axhendat e ngushta dhe përkatësitë partiake apo ato individuale.
- Të shndërrojnë Procesin e Integritetit Evropian në një proces shumëpërfshirës zhvillimi, modernizimi dhe transformimi të vendit, në përputhje me standardet e BE-së, pa minimizuar rëndësinë që paraqet në këtë aspekt respektimi i standardeve zgjedhore, procesi i luftës kundër korrupsionit e krimit të organizuar dhe trafikëve.
- Punojnë seriozisht dhe sistematikisht për të forcuar administratën publike dhe për të mundësuar depolitizimin në praktikë të saj dhe rritjen e efektshmërisë dhe profesionalizmit.

Bibliografia

http://www.evroparl.evropa.eu/summits/fei1_en.htm

<http://www.mfa.gov.al/>

http://ec.evropa.eu/enlargement/press_corner/key-documents/sap_en.htm

<http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/articles/2008/10/20/reportage-01>

<http://www.parlament.al>

<http://www.cpi.transparency.org/>
Raporti i Stabilizim Asociimit 2003
Raporti i Stabilizim-Asociimit 2004
Progres-Raporti 2005

Progres-Raporti 2006
Progres-Raporti 2007.